



PERCEPTIMI MBI KORRUPSIONIN NË UNIVERSITETE

RAPORT MONITORIMI

Dhjetor 2024



AUTOR
MATEO YSKOLLARI

QENDRESA QYTETARE

NED NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisjercqj.com.al

PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	3
2. METODOLOGJIA E STUDIMIT	4
2.1. Qasja Kërkimore	4
2.2. Pyetësi për Studentët	4
3. KORRUPSIONI DHE KUADRI LIGJOR PËR PARANDALIMIN E TIJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	5
3.1. Përkufizimi i Korrupsionit dhe Impakti i Tij	5
3.2. Kuadri Ligjor për Luftën kundër Korrupsionit në Shqipëri	6
3.3. Nënligjet dhe Rregulloret për Arsimin e Lartë	11
3.4. Reformat në Arsimin e Lartë Gjatë Trevjeçarit të Fundit (2021–2024)	12
3.5. Sfidat dhe Perspektivat për të Ardhmen	12
4. KËNDVËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	13
4.1. Dënimet për Korrupsionin në Universitetet në Shqipëri 2021- 2024	13
5. ANALIZË E DETAJUAR E GJETJEVE TË STUDIMIT	15
6. RAPORTIMI I RASTEVE TE KORRUPSIONIT NE UNIVERSITETE	20
7. PJESËMARRJA E STUDENTËVE NË RASTET KORRUPTIVE	25
8.RAPORTI PEDAGOG- STUDENT	29
GJETJET KRYESORE:	31
REKOMADIMET:	33

1. HYRJJE

Korrupsioni në sektorin e arsimit të lartë në Shqipëri ka qenë një problem i vazhdueshëm, i cili ka ndikuar në cilësinë dhe integritetin e institucioneve arsimore, si dhe në besimin e qytetarëve ndaj sistemit edukativ. Universitetet publike, që mbajnë një rol të rëndësishëm në formimin e brezave të rinj dhe zhvillimin e shoqërisë, shpesh janë shënjestër e praktikave korruptive që përfshijnë: pagesa të paautorizuara për provime, ndikime politike në shpërndarjen e burimeve financiare dhe favore për individë të caktuar në proceset e pranimit dhe graduimit. Ky fenomen ka ndikuar negativisht në transparencën, barazinë dhe cilësinë e arsimit të ofruar në Shqipëri.

Raportet më të fundit të institucioneve ndërkombëtare, si ai i Parlamentit Evropian¹ dhe Departamentit të Shtetit të SHBA, e kanë vlerësuar korrupsionin në arsim si një nga pengesat kryesore për përparimin e Shqipërisë në drejtim të integritetit të plotë në Bashkimin Evropian dhe për përmirësimin e imazhit të saj në arenën ndërkombëtare. Sipas dy raporteve të fundit të Parlamentit Evropian (2023² dhe 2024³), korrupsioni mbetet një sfidë e rëndësishme për Shqipërinë, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në sistemin arsimor dhe duke minuar besimin e qytetarëve tek institucionet publike. Po ashtu, Departamenti i Shtetit në Raportin vjetor për Shqipërinë (2023)⁴ ka theksuar se korrupsioni në arsimin e lartë është një fenomen që kërkon reforma të thella dhe angazhim të vazhdueshëm nga autoritetet për të garantuar një sistem arsimor më të drejtë dhe të ndershëm.

Ky raport monitorimi synon të shqyrtojë shkallën dhe natyrën e korrupsionit në universitetet publike në Shqipëri, duke analizuar shkaqet, pasojat dhe përpjekjet për të luftuar këtë fenomen, ku studenti si figurë qendrore, herë viktimë dhe herë palë e këtyre rasteve shfaq një nivel të lartë informacioni mbi prezencën e korrupsionit, por një nivel të ulët gatishmërie për ta raportuar dhe për të reaguar ndaj këtij fenomeni.

Pjesë e këtij studimi do të jenë gjithashtu politikat dhe masat që janë marrë nga qeveria dhe institucionet përgjegjëse, si dhe vlerësimi i efikasitetit të këtyre masave në uljen e nivelit të korrupsionit. Për të

¹ <https://www.europarl.europa.eu/>

² "Corruption in the education sector continues to be a significant challenge in Albania" (European Parliament, 2023, p. 12). (https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SĚD_2023_690%20Albania%20report.pdf)

³ "Fundamentals of enlargement including Rule of Law, the fight against organised crime, fundamental rights and fight against corruption" (faqe 10-12)/ "Education, training, employment and social objectives and leave no one behind" (faqe 18). (https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/9f9ac397-ca8a-4bde-8204-998e27ab4f51_en?filename=SWD_2024_242_2_EN_autre_document_travail_service_part1_v3.pdf)

⁴ "Corruption within higher education institutions continues to affect the quality and accessibility of education in Albania" (U.S. Department of State, 2023, p. 10). U.S. Department of State. (2023). 2023 Country Reports on Human Rights Practices: Albania. Retrieved from <https://ëëë.state.gov>

pasur një pasqyrë të saktë dhe gjithëpërfshirëse, ky raport do të mbështetet në të dhëna të mbledhura nga burime të besueshme dhe studime të mëparshme të realizuara nga institucione ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe në anketimin me studentë për të marrë si objekt monitorimi konkretisht aspektin e marrëdhënies pedagog – student dhe administrate universitare – student. Gjetjet kryesore të këtij raporti tregojnë një perceptim të lartë dhe të besueshëm të pranisë së këtij fenomeni në universitetet publike por edhe një anagzhim të ulët të strukturave për ta reduktuar atë.

2. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Gjetjet e këtij studimi bazohen në një proces anketimi të realizuar gjatë muajit nëntor 2024. Kjo anketë online iu drejtua studentëve në 12 universitetet publike në vend dhe u realizua plotësimi nga 217 studentë. Krahas me plotësimin e anketës, studimi u parapri nga kërkesat për informacion drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive të qarqeve ku lokalizohen Universitetet Publike në rrethe, nga të cilat u morën statistika lidhur me numrin e personave të kallëzuar, proceduar apo gjykuar për korrupsion, të cilët i përkasin personave akademike, gjatë tre vjecarit të fundit.

2.1. Qasja Kërkimore

Studimi përdor një qasje të kombinuar cilësore dhe sasiore për të analizuar korrupsionin në arsimin e lartë, përmes:

- Analizës së ligjeve dhe akteve nënligjore relevante.
- Vlerësimin të reformave dhe ndikimit të tyre në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në arsimin e lartë.
- Pyetësorëve dhe intervistave të strukturuar me studentët për të kuptuar perceptimin dhe përvojën mbi korrupsionin.

2.2. Pyetësori për Studentët

Para përcaktimit të kampionit, është bërë një përlllogaritje e numrit të studentëve në secilin universitet të targetuar.

Shënim: Në tabelë paraqiten numrat e studentëve marrë nga kërkesat për informacion drejtuar universiteteve. Në Universitetin Politeknik mungojnë statistikat për numrin e studentëve master, kurse Universiteti i Elbasanit nuk ka paraqitur ne përgjigje numrin e studenteve, Universiteti i Vlorës, nuk ka dhënë informacion në shkëlqje të afateve dhe ligjit për të drejtën e informimit në Republikën e Shqipërisë.

Universiteti	Popullata	Kampioni	Bachelor	Master
Univ. Mjekësisë Tiranë	6806 studentë	19 studentë	14	5
Univ. Politeknik i Tiranës	10515 studentë	84 studentë	77	7

Univ. i Tiranës	19401 studentë	66 studentë	53	13
Univ. Bujqësor i Tiranës	6047 studentë	2 studentë	1	1
Univ. i Shkodrës	3721 studentë	37 studentë	24	13
Univ. të tjera në rrethë	12311 studentë	9 studentë	8	1
Total:	58801 studentë	217 studentë	177	40

Kampioni i përzgjedhur në të gjitha Universitetet të marra së bashku ishte 217 studentë, 0.4% e popullatës. Kampioni garanton përfshirjen e studentëve që ndjekin dy nivelet e studimit dhe shpërndarja e drejtë gjinore. Siç vihet re edhe në tabelën më sipër, në procesin e anketimit janë përfshirë në total 177 studentë të nivelit Bachelor dhe 40 studentë të nivelit Master, duke siguruar kështu gjithpërfshirjen e tyre.

Të dhëna mbi nivelin e studimeve të studentëve të anketuar në Universitetet me pjesëmarrjen më të madhe.



76% e studentëve të anketuar kanë qenë vajza dhe 24% e tyre kanë qenë djem. Kjo shpërndarje e pyetësorëve sipas gjinisë i referohet raportit të INSTAT ku sipas të dhënave të grumbulluara raporti i femrave të diplomuara është më i lartë krahasuar me të meshkujve.⁵

3. KORRUPSIONI DHE KUADRI LIGJOR PËR PARANDALIMIN E TIJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

3.1. Përkufizimi i Korrupsionit dhe Impakti i Tij

Korrupsioni përfaqëson një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballlet Shqipëria, duke ndikuar drejtpërdrejt në qeverisjen, zhvillimin ekonomik dhe social, si dhe në besimin e qytetarëve tek institucionet publike. Organizata Transparency International e përkufizon

⁵ https://www.instat.gov.al/media/13332/statistika-te-diplomimeve_2022-23-update-2024.pdf

korrupsionin si "shfrytëzimi i fuqisë publike për përfitime private"⁶ dhe ky përkufizim reflektohet në situatën aktuale të Shqipërisë, ku korrupsioni është i përhapur në sektorë të ndryshëm⁷, përfshirë arsimin e lartë.

Në sektorin arsimor, korrupsioni shfaqet në disa forma:

- **Favorizimi në rekrutime dhe promovime akademike.**
- **Pranimet në universitete përmes rrugëve të padrejta.**
- **Dhënia e notave ose diplomave në këmbim të përfitimeve monetare apo favoreve të tjera.**
- **Përdorimi joefikas dhe shpeshherë abuziv i fondeve publike nga administratat universitare.**

Këto fenomene ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit të lartë, duke penguar zhvillimin akademik dhe mundësitë e barabarta për studentët.

3.2. Kuadri Ligjor për Luftën kundër Korrupsionit në Shqipëri

Republika e Shqipërisë ka miratuar një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore për të adresuar korrupsionin, duke krijuar një kornizë të fortë ligjore për parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e tij. Disa nga aktet kryesore që mbulojnë këtë fushë janë:

1. **Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"**⁸

Ky ligj synon të parandalojë situatat ku interesat private të zyrtarëve publikë mund të ndikojnë në detyrimet e tyre zyrtare. Në kontekstin e universiteteve, ai kufizon rastet kur një punonjës akademik mund të ketë përfitime personale nga pozita e tij. Konkretisht:

Neni 5 – Parimi i shmangies së konfliktit të interesave: Ky nen përcakton detyrimin për shmangien e çdo situatë ku interesat private të një zyrtari publik ndikojnë në vendimmarrjen e tij.

Për shembull: Një zyrtar universitar nuk mund të marrë pjesë në një tender ku përfshihet një kompani që ai ose familjarët e tij kontrollojnë.

Neni 6 – Mënyra e kryerjes së detyrave publike dhe detyrimi për parandalimin e konfliktit të interesit: Parashikon që zyrtarët publikë duhet të deklarojnë interesat e tyre private për të parandaluar konflikte të mundshme. Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Në rast se zyrtari nuk është i bindur për ekzistencën apo

⁶ Transparency International, *Corruption Perceptions Index 2023*.

⁷ European Commission, *2023 Enlargement Package: Albania Progress Report*.

⁸ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 29, Prill 2005.

jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me eprorët.

Në kontekstin universitar: Deklarimi është i domosdoshëm për ata që marrin pjesë në proceset e tenderimit ose emërimeve.

Neni 37 – Shkeljet dhe sanksionet (MËNYRAT E TRAJTIMIT DHE TË ZGJIDHJES SË KONFLIKTIT TË INTERESAVE): Ky nen përcakton masat administrative dhe ligjore ndaj atyre që nuk respektojnë rregullat për konfliktin e interesave.

2. Ligji Nr. 80/2015, " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë,"⁹

Ky ligj përcakton rregullat për menaxhimin e fondeve publike dhe qeverisjen e universiteteve, duke synuar rritjen e transparencës dhe autonomisë institucionale. Ai përfshin dispozita për transparencën në procedurat e pranimit dhe për menaxhimin financiar të institucioneve të arsimit të lartë.

Neni 4 dhe 5 – Parimet themelore të arsimit të lartë: Ky nen thekson parimet e transparencës, meritokracisë dhe përgjegjshmërisë në qeverisjen e institucioneve të arsimit të lartë.

Neni 15 – Detyrimet e institucioneve të arsimit të lartë

Përcakton detyrimin e institucioneve për:

- Ruajtjen e transparencës dhe llogaridhënies.
- Mbikëqyrjen dhe raportimin periodik mbi veprimtarinë akademike dhe financiare.
- Garantimin e barazisë dhe shmangien e çdo forme të diskriminimit apo favorizimit në proceset akademike.

Neni 17 – Autonomia financiare

Ky nen përshkruan mënyrën si duhet menaxhuar fondet publike dhe private:

- Shpenzimet dhe investimet duhet të jenë transparente dhe të mbikëqyrura.
- Detyrimi për raportim të detajuar për përdorimin e fondeve publike dhe burimeve të tjera financiare.

Neni 32 – Llogaridhënia e drejtuesve të institucioneve

Ky nen përshkruan përgjegjësinë e drejtuesve të institucioneve për:

- Vendimmarrjen e tyre në përputhje me ligjin.

⁹ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 164, Gusht 2015.

- Moslejimin e praktikave abuzive ose korruptive gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

Neni 62 – Procedurat e pranimit në studime

Rregullon transparencën në procesin e pranimit në arsimin e lartë:

- Publikimi i kriterëve të qarta dhe të detajuara për çdo program studimi.
- Shmangia e çdo forme manipulimi në renditjen e studentëve.
- Përdorimi i sistemeve elektronike për të siguruar paanësinë.

Neni 96 – Vlerësimi i performancës akademike

Parashikon kriteret për vlerësimin e performancës së stafit akademik, duke përfshirë:

- Respektimin e etikës akademike.
- Kontrollin për veprime që bien ndesh me integritetin akademik, si plagiaturo ose favorizimet.

Neni 109 – Këshilli i Etikës

Përcakton krijimin e Këshillit të Etikës si organ brenda çdo universiteti për të adresuar:

- Shkeljet e kodit të etikës akademike.
- Raste të raportuara për abuzim me detyrën ose korrupsion.
- Sjellje joetike nga stafi akademik apo administrativ.

Neni 132 – Sanksionet për shkelje

Përcakton ndëshkimet për shkeljet e ligjit nga individët apo institucionet, duke përfshirë:

- Marrjen e masave administrative deri në pezullimin nga detyra.
- Referimin e rasteve serioze në organet e drejtësisë.

Neni 133 – Transparenca dhe publikimi i informacionit

Detyron institucionet të:

- Publikojnë informacione mbi vendimet, financat dhe procedurat e brendshme.
- Lehtësojnë aksesin në informacion për studentët, stafin dhe publikun.

Neni 139 – Këshilli Kombëtar i Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Ky organ ka detyrën të:

- Monitorojë dhe vlerësojë veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë.
- Propozojë masa për të parandaluar korrupsionin dhe për të rritur integritetin akademik.

Neni 143 – Roli i ministrisë përgjegjëse

Ministria e Arsimit është e detyruar të:

- Kontrollon zbatimin e ligjit dhe të ndërhyjë kur konstatohet shkelje.
- Vendosë standarde për transparencën dhe luftën kundër korrupsionit.

Neni 131 – Kontrolli financiar dhe auditimi: Ky nen thekson se institucionet e arsimit të lartë duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar përdorimin korrekt të fondeve.

3. Ligji Nr. 9577, datë 10.7.2006, "Për Inspektimin dhe Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"¹⁰

Ky ligj përmban dispozita që synojnë mbikëqyrjen e përdorimit të burimeve publike dhe parandalimin e abuzimeve financiare, duke përfshirë sektorin e arsimit të lartë. Më poshtë janë nenet relevante që lidhen me ruajtjen e integritetit dhe adresimin e akteve korruptive::

Neni 2 – Fusha e zbatimit: Thekson që të gjitha institucionet publike, përfshirë universitetet, janë subjekt i inspektimit dhe auditimit.

Neni 4 – Parimet e auditimit të brendshëm: Ky nen përcakton detyrimin për pavarësi dhe objektivitet në auditimet e brendshme. Parimet kryesore përfshijnë:

- **Pavarësinë:** Auditimi duhet të kryhet pa ndikime nga drejtuesit ose palë të treta.
- **Objektivitetin:** Analizat dhe vlerësimet duhet të jenë të paanshme dhe bazuara në fakte.
- **Transparencën:** Rezultatet e auditimeve duhet të jenë të hapura për mbikëqyrje.

Shembull: Audituesit e brendshëm në universitete nuk mund të jenë persona të lidhur me drejtuesit e institucionit.

Neni 15 – Planifikimi i auditimit: Ky nen kërkon që auditimet të planifikohen bazuar në analiza të rrezikut, duke adresuar zonat më të ekspozuara ndaj korrupsionit.

¹⁰ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 84, Korrik 2006.

Neni 22 – Raportimi i parregullive: Parashikon që çdo zbulim i shkeljeve të rëndësishme financiare duhet të raportohet tek organet kompetente për hetim.

Ligji Nr. 9577 është një mjet kyç për të mbikëqyrur integritetin dhe transparencën financiare në sektorin publik, përfshirë arsimin e lartë. Dispozitat e tij për inspektimin, auditimin, dhe raportimin e shkeljeve synojnë të reduktojnë rrezikun e korrupsionit dhe të garantojnë përdorimin e duhur të burimeve publike.

4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ¹¹

Në **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë**, nenet që prekin në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë korrupsionin në arsimin publik lidhen me garantimin e integritetit, transparencës dhe barazisë në ofrimin e arsimit dhe administrimin e burimeve publike. Ja nenet përkatëse:

Neni 57 – E drejta për arsim

Barazia në arsim:

Shteti garanton të drejtën për arsim për të gjithë, duke ndaluar çdo formë diskriminimi apo favorizimi të paligjshëm.

Në mënyrë indirekte, ndalon korrupsionin në procedurat e pranimit ose përfitimet e padrejta që mund të cenojnë këtë barazi.

Neni 59 – Objektivat socialë të shtetit

Detyrimi i shtetit për promovimin e arsimit cilësor dhe etik:

Krijimi i kushteve që arsimi të jetë i drejtë dhe në përputhje me standardet morale.

Objektivat për shmangien e abuzimeve financiare dhe korrupsionit përmes garantimit të menaxhimit të duhur të burimeve publike në arsim.

Neni 94 – Përgjegjësitë e ministrave

Ministrat, përfshirë Ministrin e Arsimit, mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për administrimin e sektorëve që mbulojnë, duke përfshirë edhe arsimin.

Përgjegjësia për keqpërdorim të fondeve apo lehtësimin e praktikave korruptive bie edhe mbi ata.

Neni 99 – Urdhërat dhe aktet administrative

¹¹ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 28, Nëntor 1998 (me ndryshimet e fundit të miratuara në 2020).

Çdo vendim administrativ, përfshirë ata që lidhen me arsimin (të tilla si rekrutimet apo tenderat në universitete), duhet të jenë të bazuara në ligj dhe transparente. Ky nen ndalon favorizimet korruptive.

Neni 135 – Gjykata Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese ka kompetencën të shqyrtojë rastet ku korrupsioni ose favorizimi në sektorin e arsimit mund të shkelë parimet kushtetuese, si barazia dhe integriteti në menaxhimin publik.

Neni 145 – Pavarësia e gjykatave

Pavarësia e gjyqësorit është kyçe në trajtimin e rasteve të korrupsionit në arsim. Korrupsioni në arsimin publik mund të shqyrtohet në kuadër të ligjeve të zbatueshme, të cilat garantojnë ndëshkimin e shkeljeve.

5. Strategjia Kombëtare Antikorrupsion¹²

Strategjia për periudhën 2020–2025 përfshin masa specifike për të përmirësuar qeverisjen dhe për të luftuar korrupsionin në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë arsimin.

Prioriteti 3 – Rritja e transparencës në arsimin e lartë: Kjo strategji përcakton angazhimin për digjitalizimin e procedurave administrative, duke reduktuar ndërhyrjen njerëzore dhe mundësinë për korrupsion.

Masat specifike:

- Zbatimi i sistemit elektronik për procedurat e pranimit dhe menaxhimin e fondeve.
- Kontrolli i zbatimit të ligjit nga inspektorë të posaçëm antikorrupsion në universitete.

Raportimi dhe monitorimi: Përfshin detyrimin për raporte periodike mbi rastet e identifikuar të korrupsionit dhe masat e marra.

3.3. Nënligjet dhe Rregulloret për Arsimin e Lartë

Në arsimin e lartë janë miratuar disa akte nënligjore dhe rregullore që synojnë të adresojnë problematikat e korrupsionit:

- **Rregulloret për prokurimet publike¹³:** Sigurojnë transparencë dhe konkurrencë në proceset e tenderimit për infrastrukturën universitare dhe blerjet e tjera.
- **Rregulloret për pranimin e studentëve¹⁴:** Vendosi kriteret të qarta dhe të standardizuara për pranimet në programet universitare.

¹² Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare Antikorrupsion 2020–2025.

¹³ Agjencia e Prokurimit Publik, Udhëzimet dhe raportet e vitit 2022, faqja zyrtare: www.app.gov.al.

¹⁴ Ministria e Arsimit dhe Sportit, Udhëzimet për pranimet në universitetet publike, Viti Akademik 2024–2025.

- **Rregulloret për transparencën financiare**¹⁵: Përfshijnë detyrimin e universiteteve publike për të publikuar raportet financiare dhe të ardhurat nga tarifat studentore.

3.4. Reformat në Arsimin e Lartë Gjatë Trevjeçarit të Fundit (2021–2024)

Në periudhën e fundit janë ndërmarrë disa reforma të rëndësishme për të luftuar korrupsionin dhe për të përmirësuar transparencën në arsimin e lartë:

1. Digjitalizimi i shërbimeve administrative dhe akademike:¹⁶

- Universitetet publike kanë zbatuar sisteme të digjitalizuara për regjistrimin e studentëve dhe menaxhimin e notave, duke reduktuar ndërhyrjet e paligjshme në këto procese.
- Portale të reja, si "e-Albania", janë përdorur për aplikimet dhe pranimin në universitete.

2. Rritja e kapaciteteve të mbikëqyrjes financiare¹⁷:

- Auditimet periodike nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit kanë përfshirë rishikimin e fondeve publike dhe transparencën në kontratat e lidhura nga universitetet.

3. Forcimi i masave ndëshkuese për korrupsion¹⁸:

- SPAK ka hapur disa çështje të rëndësishme që lidhen me korrupsionin në sektorin arsimor, duke përfshirë rastet e shpërdorimit të fondeve dhe favorizimit në pranime.

4. Rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimeve¹⁹:

- Është punuar me stafin akademik dhe administrativ për të ndërtuar një kulturë integriteti dhe për të parandaluar praktikat korruptive.

3.5. Sfidat dhe Perspektivat për të Ardhmen

Pavarësisht reformave të ndërmarra, mbeten sfida të rëndësishme për të adresuar korrupsionin në arsimin e lartë:

- **Kultura e mosndëshkimit**²⁰: Shumë raste të dyshuara për korrupsion nuk çojnë në ndëshkime konkrete.

¹⁵ Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin."

¹⁶ Ministria e Arsimit dhe Sportit, Raporti i Performancës 2023.

¹⁷ Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit, Raporti Vjetor 2022.

¹⁸ Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Raporti i Performancës 2022.

¹⁹ Ministria e Arsimit dhe Sportit, Programet e Trajnimit për Stafin Akademik, 2021–2024.

²⁰ Instituti i Kërkimeve për Qeverisje dhe Transparencë, Raporti mbi Luftën Kundër Korrupsionit në Arsimin e Lartë, 2023.

- **Mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore²¹:** Auditimet dhe mbikëqyrja shpesh janë të kufizuara për shkak të resurseve të pamjaftueshme.
- **Mungesa e transparencës në vendimmarrje:** Disa universitete ende nuk i publikojnë të gjitha raportet financiare dhe proceset e vendimmarrjes.

4. KËNDVËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

4.1. Dënimet për Korrupsionin në Universitetet në Shqipëri 2021-2024

Në periudhën 2021–2024, Shqipëria ka intensifikuar luftën kundër korrupsionit në sektorin publik, përfshirë arsimin e lartë. Rastet e ndëshkimeve të raportuara për korrupsion në universitete dhe institucionet arsimore përfshijnë veprimtari të ndryshme të jashtëligjshme, që nga favorizimet për pranime e deri te shpërdorimet financiare.

Më poshtë janë disa raste dhe analiza të ndëshkimeve, të bazuara në burime mediatike dhe institucionale:

1. Rryshfet kundrejt notës së provimit

Në 24 Shtator 2020 ²²një pedagog i Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin ‘Fan Noli’ ka rënë në prangat e policies i akuzuar se ka përfituar shuma monetare në këmbim të dhënies së provimeve për studentët.

Në Akademinë e policisë në dhjetor të vitit 2021 një inspektor student i ka premtuar pedagogut të këtij institucioni të arsimit të lartë 4.000 euro për të marrë gradën nën-komisar dhe ka përdorur dokumente të falsifikuara. Pas raportimit të aktit korruptiv, policia arreston studentin dhe pedagogun²³.

2. Favore Seksuale në këmbim të provimit

Policia e Elbasanit arrestoi një pedagog pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani”²⁴, Elbasan, për veprat penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”. Ndalimi i pedagogut u bë pas pamjeve të publikuara në media ku 36 vjecari i kërkonte favore seksuale një studenteje në këmbim të dhënies së provimeve.

²¹ Instituti Shqiptar për Demokraci dhe Edukim, *Studimi mbi Universitetet Publike në Shqipëri*, 2022.

²² <https://top-channel.tv/2020/09/24/emri-ryshfet-per-te-kaluar-provimet-arrestohet-pedagogu-i-fakultetit-te-shkencave-sociale-ne-korce/>

²³ <https://euronews.al/testimi-i-policise-arrestohen-per-korrupsion-pedagogu-dhe-studenti/>

²⁴ <https://www.vizionplus.tv/favore-seksuale-ne-kembim-te-provimeve-arrestohet-pedagogu/>

3. Raste të Kallëzimeve dhe Dënimeve për Korrupsion në Universitetet Publike (2021-2024)

1. Operacioni “Teza” (2023)

Në Universitetin e Elbasanit, një grup prej 8 personash²⁵, përfshirë pedagogë dhe një sekser, u arrestua për korrupsion. Hetimet zbuluan se ata kërkonin ryshfet për kalimin e provimeve ose përmirësimin e notave. Në mesin e pedagogëve të arrestuar janë Monika Hodaj, Adrian Shingjergji dhe Beatriçe Gani, ndërsa një pedagoge tjetër është shpallur në kërkim. Provat përfshinin regjistrime filmike dhe kontrolle të dokumenteve.

2. Operacioni “Sezoni” (2024)

Në një tjetër rast në Universitetin “Aleksandër Xhuvani,” Elbasan, hetimet zbuluan një rrjet të sekserëve që ndikonin te pedagogët²⁶ për t'u dhënë studentëve nota kaluese në këmbim të pagesave. Sekserët Medi Hana, Qamil Murataj dhe Skënder Stafa u arrestuan pas një hetimi dy-mujor nga Prokuroria dhe Policia e Krimeve Ekonomike.

3. Rasti i Ryshfetit për Provimet (2022)

Në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Elbasanit, disa pedagogë u kapën duke kërkuar pagesa nga studentët²⁷ për të kaluar provimet e mbartura. Denoncimet e studentëve ishin bazuar në regjistrime dhe prova të tjera, çka çoi në pezullimin dhe ndjekjen penale të disa personave

4. Korrupsioni Administrativ dhe Ndikimi i Sekserëve (2023)

Një tjetër hetim zbuloi përfshirjen e administratës universitare²⁸ në favorizime të paligjshme për regjistrimin në programe të preferuara ose përfitime të tjera në këmbim të ryshfetit. Në shumë raste, sekserët vepronin si ndërmjetës mes studentëve dhe stafit akademik për të siguruar pagesat dhe rezultatet.

²⁵ <https://www.oranews.tv/vendi/nami-n-universitetin-e-elbasanit-moren-leke-nga-studentet-per-ti-kaluar-ne-i1196532>

<https://shqiptarja.com/lajm/korrupsioni-ne-universitetin-e-elbasanit-prokuroria-jep-detajet-per-7-pedagoget-dhe-sekserin-u-moren-si-prove-filmimet-procesverbali-i-lendeve-dhe-u-kontrolluan-banesat>

²⁶ <https://shqiptarja.com/lajm/serish-korrupsion-ne-universitetin-e-elbasanit-arrestohen-tre-seksere-ne-hetim-3-pedagogë>

²⁷ <https://www.oranews.tv/vendi/nami-n-universitetin-e-elbasanit-moren-leke-nga-studentet-per-ti-kaluar-ne-i1196532>

<https://shqiptarja.com/lajm/korrupsioni-ne-universitetin-e-elbasanit-prokuroria-jep-detajet-per-7-pedagoget-dhe-sekserin-u-moren-si-prove-filmimet-procesverbali-i-lendeve-dhe-u-kontrolluan-banesat>


²⁸ <https://top-channel.tv/2024/01/30/perceptimi-i-korrupsionit-transparency-international-publikon-raportin-shqiperia-progres-ja-si-renditemi3/>

<https://collections.fes.de/publikationen/content/titleinfo/454804>


5. ANALIZË E DETAJUAR E GJETJEVE TË STUDIMIT

5.1. Prania e Korrupsionit në universitete


A është i pranishëm fenomeni i korrupsionit në fakultetin/Universitetin tuaj?




Analizën e pranisë së fenomenit të korrupsionit në universitete kemi tentuar ta realizojmë përmes perceptimit të studentëve që aktualisht ndjekin programet e studimit bachelor dhe master.



77% Po, ekziston



77% e studentëve, të anketuar, thonë se korrupsioni ekziston në universitetet e tyre. 19.4% e studentëve nuk japin përgjigje, shoqëruar me mendimin se nuk kanë patur përvoja personale të fenomenit të korrupsionit dhe vetëm 3.7% e mohojnë atë




Parë në raport krahasimor mes katër universiteteve me numrin më të lartë të të anketuare, prania e korrupsionet shfaqet më e lartë në Universitetin e Mjekësisë me 100% dhe më e ulët në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Universitetin e Shkodrës me 75% dhe 76%.

Kjo diferencë mund të ekzistojë për shkak të ndikimit të zhvillimeve të fundit në Universitetin e Mjekësisë, të cilat dukshëm kanë ulur besimin e studentëve dhe kanë rritur numrin e fenomeneve korruptive në krahasim me Universitetet e tjera.

Nga ana tjetër nëse i referohemi më ngushtë perceptimit të studentëve lidhur me fenomenin e shfaqjes së korrupsionit në nivel programi studimi apo departamenti, 62.2 % e të anketuarve pranojnë ekzistencën e fenomenit në këtë nivel. Ky trend në rënie mund të jetë edhe për shkak të frikës që mund të kenë pasur studentët për të qenë plotësisht të sinqertë në lidhje me programin e tyre të studimit, duke qenë se janë më afër kësaj hierarkie sesa rangut universitar, por mund të themi se pavarësisht kësaj tendence numri mbetet relativisht e lartë, ku 135 studentë nga 217 vlerësojnë si ekzistent këtë fenomen.

A është i pranishëm fenomeni i korrupsionit në degën tuaj të studimit?




■ Po, ekziston ■ Jo, nuk ekziston ■ Nuk e di/ Pa përgjigje

Në vijim të analizës për të kuptuar vërtetësinë e fenomenit dhe për t'u bindur se të anketuarit bazohen në vetë përvojat personale e përvojat e bashkëmoshatarëve ose familjarëve dhe jo qasjet e palëve të tjera, studentëve u është drejtuar pyetja: “Nëse po (pra, nëse mendojnë se korrupsioni ekziston në nivelet e përmendura më sipër), si jeni vënë në dijeni të praktikave korruptive?”

Bazuar në dy kategori së bashku, vihet re se 79% apo 155 nga 217 studentë bazohen në përvojat personale, përvojat e

Nëse po, si jeni vënë në dijeni të praktikave korruptive?




bashkëmoshatarëve ose familjarëve. Ndërkohë, krahas ndikimit të medias në jetën tonë, vetëm 15% shprehen se janë vënë në dijeni të praktikave korruptive përmes raportimeve në media.

Korrupsioni në universitete nuk është një koncept i largët apo i pa imagjinueshëm, por një realitet i prekshëm ku aktorë të ndryshëm brenda sistemit arsimor luajnë role kyçe. Shpesh përfshihen si stafi akademik ashtu edhe administrata e institucioneve të arsimit të lartë. Në bazë të të dhënave të mbledhura, 26% e studentëve besojnë se trupa akademike është e përfshirë, ndërsa 5% e tyre e lidhin korrupsionin me administratën universitare.

Një gjetje tepër pikante nga pyetja “Ku mendoni se shfaqet më tepër korrupsioni?” është se 51% e të anketuarve besojnë se të dy grupet, si administrata ashtu edhe trupa akademike, janë të përfshira në mënyrë të barabartë. Kjo sinjalizon se këta aktorë të sistemit janë të lidhur me njëri-tjetrin në përfshirjet korruptive, ky është një fakt për këtë lidhje sepse roli ndërmjetës mes studentëve dhe pedagogëve në shumicën e rasteve luhet nga punonjësit e administratës.

Kur përfshijmë këto përqindje, rezulton se 82% e studentëve mendojnë se korrupsioni është i pranishëm si tek stafi akademik ashtu edhe tek administrata, duke dëshmuar një nivel shqetësues të përhapjes së fenomenit.



5.2. Format e shfaqjes së korrupsionit në universitete

Cilat janë format me të cilat paraqitet korrupsioni me shpesh?

Korrupsioni në universitete duket se është një pasqyrë e gjallë e krijimtarisë njerëzore. Nga pagesat për nota e deri te librat e detyruar, grafiku në vijim na mëson një të vërtetë të madhe: arsimi i lartë është kthyer në një treg ku studentët janë klientë dhe "shërbimet" e ofruara

janë të larmishme. Pra, në vend që të mësojmë mbi etikën dhe moralin, duket se kemi përvetësuar artin e biznesit në format më absurde të tij!

"Pagesa në këmbim të notës" zë vendin kryesor ku 184 studentë apo 39% e totalit, na tregojnë qartazi se kjo formë është e perceptuar si më e përhapura. Kjo vë në dukje një shqetësim të madh mbi integritetin akademik, ku duket se vlerësimi i dijes është shndërruar në një transaksion financiar.


Ndjekur nga, **"Detyrimi për blerje librash"** ku 26% e studentëve tregojnë se në universitetet tona kemi një tjetër fenomen, atë të ndihenpresionit të detyruar të blerjes së literaturës së propozuar, shpeshherë të autorësisë së pedagogëve, për të kaluar lëndët. Kjo përforcon idenë se mekanizmat që duhet të mbështesin mësimdhënien mund të përdoren në mënyrë abuzive.

"Nepotizmi", me 11% të studentëve të pyetur, evidenton se lidhjet familjare apo sociale vazhdojnë të kenë një ndikim të ndjeshëm në sistemin arsimor. Për shumë studentë, perceptimi që "lidhjet e duhura" mund të sigurojnë përparësi është shqetësues dhe nënvizon mungesën e meritokracisë.

"Favoret seksuale", të raportuara nga 7%, mbeten një nga format më shqetësuese të korrupsionit, ndonëse me përhapje më të ulët në raport me format e tjera. Kjo formë jo vetëm që dëmton procesin arsimor, por ngre edhe çështje të rëndësishme etike dhe ligjore.

Ndërkohë, forma si **"Shitja e shërbimeve në administratën e universitetit apo konvikteve"** dhe **"Detyrimi për ndjekje të kurseve private"** janë më pak të përhapura, me përkatësisht 4% dhe 10% të të pyeturve. Megjithatë, prania e tyre tregon se studentët shpesh përballen me presione të ndryshme ekonomike apo burokratike për të përmbushur kërkesat akademike.

● Pagesë në këmbim të notës	184
● Favore seksuale	33
● Nepotizëm	53
● Detyrim për blerje librash	124
● Shitje e shërbimeve në administratën e universitetit apo konviktit	18
● Detyrim për ndjekje të kurseve private me lektorin e lëndës	47
● Other	11



Cilat janë format e komunikimit mes personave të përfshirë në një marrëdhënie korruptive?

Studentët paraqesin përqindje të ndryshme të mënyrave të komunikimit mes aktorëve të përfshirë në marrëdhënie korruptive, duke identifikuar disa kanale të përdorura për të kryer veprimtari të tilla. Secila prej kategorive ofron një perspektivë mbi mënyrat si ndërveprojnë individët brenda një sistemi të korruptuar.


Kategoria me pjesëmarrjen më të lartë përfaqëson një kombinim të komunikimit të drejtpërdrejtë dhe ndërmjetësimi nga një person i tretë, në masën 53% të anketuarve na tregojnë se shumica e veprimtarive korruptive zhvillohen në mënyrë të dyfishtë. Kjo tregon fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë e aktorëve për të përdorur metoda të ndryshme sipas situatës. Për shembull, studentët në anketë shprehen se në disa raste mund të preferohet ndërmjetësimi për të ruajtur distancën dhe për të shmangur rrezikun e ekspozimit, ndërsa në raste të tjera 16% e të anketuarve shprehen se mund të ketë nevojë për një kontakt më të drejtpërdrejtë për negociata me pedagogun.

Kjo metodë mund të jetë më e zakonshme në raste ku ekziston një marrëdhënie më e afërt mes individëve ose ku nuk ka nevojë për ndërmjetësim. Përkundër rreziqeve të larta të ekspozimit, kjo formë mund të përdoret kur besimi mes palëve është i fortë ose kur çështja konsiderohet me pak rrezik.

Nga ana tjetër 28% e studentëve kanë raportuar se ndërmjetësimi përmes një pale të tretë është një mënyrë e zakonshme e komunikimit në veprimtaritë korruptive. Kjo metodë siguron një shtresë të shtuar anonimiteti për të dyja palët dhe redukton mundësinë e ekspozimit direkt. Në universitet, shpesh sekretariatet, administratorët apo individë të tjerë brenda sistemit shërbejnë si ura ndërmjetëse midis studentëve dhe pedagogëve. Kjo formë tregon se korrupsioni është i organizuar dhe shpesh përfshin një rrjet të gjerë aktorësh.

Të dhënat tregojnë qartë se shumica e marrëdhënieve korruptive funksionojnë përmes një kombinimi të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Kjo tregon se korrupsioni është një proces i shumëanshëm dhe i mirëplanifikuar.

● Komunikim i drejtpërdrejtë	34
● Njëpërmjet një personi të tretë	60
● Të dyja opsionet më sipër	114
● Other	9





6. RAPORTIMI I RASTEVE TE KORRUPSIONIT NE UNIVERSITETE

Deri më tani kemi kuptuar se në universitetet publike në tërësi kemi përhapje të fenomenit të korrupsionit bazuar mbi qasjen e aktorëve kryesorë që preken, studentëve. Është e udhës që në vijim të analizës nëpërmjet pyetjeve “A keni dëgjuar për raste korruptive në universitetin tuaj gjatë periudhës së studimit?” dhe “A janë marrë masa ose a janë denoncuar ato?” të kuptojmë jo vetëm përhapjen e fenomenit, por më së shumti çfarë ndodh më pas. A merren masa dhe adresohen rastet në strukturat brenda universitetit dhe organet e hetimit apo korrupsioni në universitete është një akt që kalon në heshtje?


Për të marrë një panoramë akoma më të gjerë, analizës i bashkëlidhen edhe statistikat e marra nga prokuroria e përgjithshme, prokuroritë e qarqeve përkatëse në të cilat lokalizohen edhe universitetet publike të rretheve, si edhe te dhënat e marra nga SPAK.

71% e të anketuarve shprehen se kanë dëgjuar për raste korruptive në universitetet e tyre gjatë periudhës së studimeve. Ky rezultat nënkupton një nivel të lartë perceptimi ose informimi rreth korrupsionit në ambientin universitar, ç’ka identifikon një problem të përhapur dhe të njohur gjerësisht nga studentët. Nga na tjetër ky grup përfaqëson jo vetëm ata që mund të kenë qenë viktima të këtyre rasteve, por edhe ata që kanë dëgjuar përmes burimeve të tjera (miq, të afërm, media ose diskutime të përgjithshme). Por a janë studentët të gatshëm që këto raste të cilat i flasin gjerësisht në përditshmëri, me emra konkretë, shpeshherë edhe me shifra t’i raportojnë në organet përkatëse?



Realiteti vërteton të kundërtën. Mosinteresi i studentëve për të reaguar është një tregues i qartë i dy faktorëve kryesorë, frikës nga autoriteti i akademikut dhe mosbesimi në strukturat përkatëse për gjykimin e drejtë të fenomenit. Ndërkaq 49% e tyre shprehen se rastet e korrupsionit nuk janë denoncuar, 47% nuk kanë përgjigje. “Nuk i denoncojmë këto raste, sepse kemi frikë se pedagogu nuk na jep provimin”, shprehet një pjesë e konsiderueshme e studentëve të anketuar. Por, edhe pse një pjesë e vogël (4%) mendojnë se rastet korruptive denoncohen, vetëm 2% e të anketuarve shprehen se janë marrë masa për adresimin e tyre, 39% nuk kanë informacion mbi masat e marra dhe 59% e tyre nuk kanë përgjigje. Pra studentët jo vetëm që

nuk revoltohen e nuk denoncojnë, por nëse i grupojmë dy kategoritë “nuk janë marrë masa” dhe “nuk e di/ pa përgjigje”, shohim se 98% e tyre nuk kanë as interes të mësojnë çfarë ndodh me rastet e raportuara nga të tjerë.



Në vijim të analizës do të shohim konkretisht sa raste janë raportuar në organet hetimore dhe si janë ndjekur dhe gjykuar këto të fundit.

Nga verifikimi i kryer në zyrat e regjistrat të prokurorive lidhur me kallezimet/procedimet penal dhe me numrin e individëve, pjesë e personelit akademik të Universiteteve Publike në Shqipëri, gjatë viteve 2021 - 2024, rezulton të jenë regjistruar:

Raste të korrupsionit aktiv			Raste të korrupsionit pasiv		
Nr. individësh pjesë e personeleve akademike të paditur: 17			Nr. individësh pjesë e personeleve akademike të paditur: 17		
çështje në gjykim		çështje të pushuara	çështje në gjykim		çështje të pushuara
Fajtor	I pafajshëm	6	Fajtor	I pafajshëm	6
10	-		10	1	

Të dhënat e marra nga regjistrat e prokurorive ofrojnë një panoramë statistikore të rasteve të korrupsionit aktiv dhe pasiv për personelin akademik të paditur. Secili grup përbëhet nga 17 individë të përfshirë gjatë tre viteve dhe analizat tregojnë disa modele interesante në lidhje me mënyrën se si janë trajtuar këto çështje nga sistemi gjyqësor.

Këto të dhëna tregojnë një ngjashmëri të konsiderueshme midis rasteve të korrupsionit aktiv dhe pasiv sa i përket numrit të çështjeve të pushuara dhe individëve të shpallur fajtorë. Megjithatë, në rastet e

korrupsionit pasiv, ka një rast të vetëm ku një individ është shpallur i pafajshëm, ndërsa për korrupsionin aktiv nuk ka të tillë. Kjo tregon se, në përgjithësi, procedurat juridike për të dyja llojet e korrupsionit kanë një prirje të ngjashme për sa i përket rezultatit të gjykimeve, me një përqindje të lartë fajësie dhe një pjesë të konsiderueshme çështjesh të pushuara.

Gjatë periudhës 2021-2024, **SPAK** ka trajtuar raste të korrupsionit që përfshijnë personel akademik në Universitete Publike. Në total, janë kallëzuar 2 pedagogë dhe janë hetuar 7, me përqendrim më të lartë të rasteve në vitin 2024 (5 raste). Në të njëjtin vit, për 1 person është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Nga ana tjetër, për të gjithë periudhën, nuk ka pasur raste të pushimit të çështjeve penale për këtë kategori. Megjithatë, janë dërguar në gjyq vetëm 2 raste: njëri në vitin 2022 dhe tjetri në vitin 2023. Këto të dhëna tregojnë se, ndonëse ka nisur një proces për adresimin e korrupsionit në universitete, përpjekjet ende përballen me sfida, duke pasur numër të kufizuar procedimesh të finalizuara në gjykatë.

Tabela Përmbledhëse e Procedimeve të SPAK për Korrupsion në Universitete (2021-2024)

Viti	Kallëzime Penale	Persona të Hetuar	Mosfillim Procedimi	Pushime Çështjesh	Raste të Dërguara në Gjyq
2021	1	1	0	0	0
2022	0	0	0	0	1
2023	1	1	0	0	1
2024	0	5	1	0	0
Totali:	2	7	1	0	2

Për të parë trendin e numrit të personave të paditur nga viti 2021 deri në vitin 2024, do të bëjmë një ndarje të thjeshtë të rasteve sipas viteve:

Viti kalendarik	Numri i të paditurve nga personeli akademik ne Prokurori
2021	3
2022	1
2023	6
2024	8

Shifrat e viteve të fundit tregojnë një prirje në rritje të rasteve të padive ndaj personelit akademik, duke e bërë këtë një çështje që kërkon

vëmendje të veçantë nga autoritetet e drejtësisë dhe institucionet arsimore. Viti 2024 me 8 të paditur, paraqet numrin më të lartë të rasteve gjatë periudhës së analizuar. Kjo rritje mund të lidhet me kontrole më të ashpra nga autoritetet ose me një rritje të aktiviteteve të dyshuara të korrupsionit nga personelet akademike.

Nga 2021 deri në 2024, numri i të paditurve është rritur ndjeshëm, duke kaluar nga një mesatare prej 2–3 rasteve vjetore në fillim, në 8 raste në vitin e fundit.

Në kodin penal shqiptar korrupsion aktiv dhe pasiv përkufizohet dhe parashikon dënime që fillojnë nga 6 muaj deri në 8 vjet për palët e përfshira sipas neneve përkatëse:

- Neni 224 Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

- Neni 259 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet²⁹.

6.1. Besueshmëria e studentëve kundrejt ndëshkimit të rasteve korruptive

Në vijim të këtij arsyetimi ku studentët janë të informuar mjaftueshëm për elementët korruptivë brenda universiteteve të tyre, nuk i denoncojnë ato, por edhe mendojnë se nuk merren masa apo janë të lëkundur rreth ndëshkimit të këtyre rasteve, lind natyrshëm pyetja: “A kemi të bëjmë me lidhje të forta nepotike mes akademikëve dhe organeve hetimore, të cilat lëkundin besueshmërinë e studentëve në ndëshkueshmërinë e drejtë të rasteve të ndryshme të denoncimit të korrupsionit?”. Përgjigjja do ishte teper e thjeshtë sikur këta të fundit të ishin persona të thjeshtë, pa impakt dhe të “pastër” nga lidhjet dhe njohjet e shumta. Në shumë raste, këta individë janë figura të njohura në fushën akademike, që mbajnë pozita të larta në shoqëri, tituj dhe grada shkencore. Madje edhe punë të tjera jashtë kuadrit akademik ku shpeshherë kanë lidhje të ngushta personale ose nepotike me organet hetimore. Edhe kur nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt, shpesh


²⁹ <https://www.qbz.gov.al/Kode/Kodi%20Penal-2017.pdf>

rezultojnë të lidhur me praktika korruptive, duke përfundimisht nga pagesat që kryhen në këmbim të notave. Në këtë kontekst, në këtë formë sistemi i ndëshkimit nuk arrin të godasë as këto "figura të rëndësishme" dhe as bashkëpunëtorët e tyre.

Vetëm 11% e studentëve të anketuar tregojnë një nivel besimi në aftësinë e sistemit për të ndëshkuar rastet korruptive. Këta studentë janë të bindur se sistemi i drejtësisë funksionon si duhet në rastet të tilla, pa marrë parasysh realitetin e hidhur në të cilin ndodhemi. Nga ana tjetër 56% e të pyeturve, që përbëjnë edhe numrin më të madh, janë plotësisht të pashpresë, ndërsa 33% janë të pavendosur në pikëpamjet e tyre. Këta të fundit nuk arrijnë të krijojnë një perspektivë frymëzuese. Ata mendojnë se ndëshkimi shpesh kufizohet tek individët me rol të vogël dhe pa ndikim, si punonjësit administrativë ose ndërmjetësit, duke u paraqitur si një sukses i luftës kundër korrupsionit.

Nga këndvështrimi i tyre, këto raste ndëshkimi nuk adresojnë rrënjët e problemit, por shërbejnë më shumë për të dhënë përshtypjen e një sistemi funksional. Në këtë mënyrë, fenomeni i korrupsionit duket se trajtohet me një qasje të pabarabartë dhe me kritere të ndryshme, duke lënë hapësirë për dyshime mbi efektivitetin e ndëshkueshmërisë reale.


Sa besim keni tek ndëshkimi i drejtë i rasteve korruptive në universitetin/fakultetin tuaj



■ kam shume besim ■ kam disi besim ■ nuk kam aspak besim

7. 7. PJESËMARRJA E STUDENTËVE NË RASTET KORRUPTIVE

Një studim i publikuar në "Teaching More by Grading Less (or Differently)"³⁰ tregon se notat mund të ulin interesin për të mësuar dhe të risin ankthin, duke nxitur motivimin e jashtëm në vend të atij të brendshëm dhe vë në dukje se nota shpesh ndikon në perceptimin e studentëve, duke u atribuar cilësi pozitive apo negative vetëm mbi bazën e rezultateve akademike.



Kjo qasje jo vetëm që mund të demoralizojë ata që nuk arrijnë rezultate të larta, por edhe të krijojë një presion të panevojshëm te ata që përpiqen të ruajnë standardet më të larta. Ndërkohë, shumë ekspertë sugjerojnë se është e

rëndësishme të promovohen metoda alternative vlerësimi që i japin përparësi kreativitetit, mendimit kritik dhe zhvillimit të aftësive praktike, në vend që të mbështeten vetëm te shifrat. Në vend të kësaj, promovimi i metodave alternative të vlerësimit, si vlerësimi formativ, mund të nxisë një angazhim më të thellë ndaj dijes dhe të reduktojë praktikën e dëmshme si korrupsioni në arsim. Sipas një artikulli në "Formative Assessment"³¹ vlerësimi formativ është një nga mënyrat më të fuqishme për të rritur motivimin e studentëve.

Pavarësisht këtyre, dukshëm "kulti i notës" tek studentët mbetet një fenomen që sa vjen dhe ushqehet akoma më shumë. Bazuar anketimit, 38% e studentëve do të ofronin para kundrejt një note më të mirë, 68% e tyre nuk kanë këtë qasje, ndërsa 14% e studentëve do ta mendonin ofrimin e rryshfetit, por nuk janë të sigurt.

Një gjetje tepër interesante janë përgjigjet e pyetjes **"A do të raportoni raste korruptive që keni dëshmuar vetë?"**, ku shohim nga ana krahasimore një afërsi të rezultateve të tre përgjigjeve, që pozicionon studentin të gjendur në një udhëkryq kur bëhet fjalë për denoncimin e rasteve të dëshmuara vetë. Vetëm 34% e studentëve do të ishin të gatshëm të raportonin. Ndërsa 29% e tyre shprehen të



³⁰ <https://www.lifescied.org/doi/10.1187/cbe.cbe-14-03-0054>

³¹ <https://www.teachthought.com/pedagogy/difference-between-assessment-of-for-learning/>

bindur që nuk do të raportonin kurse kategoria e studentëve të lëkundur përbën 37% të kampionit. Ndër arsyet e mos raportimit janë:

1. Frika e hakmarrjes nëpërmjet penalizimit me note
2. Mosbesimi në marrjen e masave
3. Klanet e forta brenda universitetit
4. Mosinteresi i studentëve lidhur me raste që nuk i prekin ata direkt

Nga ana tjetër, natyrshëm lind pyetja se sa tolerantë janë studentët kundrejt korrupsionit. Pavarësisht dilemave në raportimin e rasteve korruptive, në formë kontradiktore studentët në masën 77% shprehën se nuk e tolerojnë fenomenin e korrupsionit, ndërkohë që 19% e tyre e shohin disi të tolerueshëm.

Tepër problematik mbetet rezultati se ekziston një pjesë e vogël, por tepër e bindur, e cila e sheh korrupsionin si një element jo shqetësues dhe që mund të tolerohet. Ky grup përbën 4% të të anketuarve, por nisur nga fakti se fenomene të tilla diskutohen ngushtësisht mes studentëve në përditshmëri, mundësitë për të ndikuar negativisht në masë janë të mëdha. Shpërndarja e këtij mostolerimi identifikohet në varësi të rasteve, ku edhe pse 77% e të anketuarve nuk e tolerojnë korrupsionin, shfaqin tolerance në raste specifike. Për shembull, një pjesë e këtij grupimi të studentëve nuk janë aspak tolerantë lidhur me marrjen e parave kundrejt notës, por nuk e shohin shqetësim blerjen e detyruar të librave dhe këtë mendim e shoqërojnë me justifikimin se pedagogët paguhen pak për punën që bëjnë dhe formimin që ata kanë. Në kënvështrim më të përgjithshëm 8 nga 10 studentë nuk e tolerojnë fenomenin e korrupsionit. Ajo që vihet re është se 6 nga 8 studentët që nuk tolerojnë raste të tilla janë vajza, gjë që përkon jo vetëm me përqindjen e të diplomuarve sipas INSTAT ku pjesa më e madhe janë vajza, por edhe me rezultatet e ardhura nëpërmjet anketës ku gjinia femërore është më e ekspozuar ndaj rasteve korruptive.

8 nga 10 studentë

Nuk e tolerojnë fenomenin e korrupsionit
ku 6 prej tyre janë vajza

77%



Të pyetur rreth shkaqeve të korrupsionit në fakultetin e tyre, ndryshe nga perspektiva e vitit 2018, ku studentët vinin në dukje mungesën e kulturës së denoncimit të rasteve, sot, 6 vite pas ku dukshëm kjo kulturë është përmirësuar, kemi shfaqur një fenomen sinjalizues dhe cilësor, **“mentaliteti i studentëve për të arritur lehtësisht notat e mira”**.


Në vitet e fundit, universitetet shqiptare kanë përjetuar një rënie të dukshme në cilësinë e arsimit dhe performancën akademike. Sipas të dhënave të INSTAT numri i studentëve në Shqipëri ka pësuar një rënie të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Në vitin akademik 2023-2024, numri i studentëve arriti në 116.9 mijë, duke shënuar një ulje prej 3.6% krahasuar me vitin e mëparshëm. Kjo rënie lidhet ngushtë me migrimin e “trurit” të studentëve dhe uljen e nivelit të universiteteve, në të cilat studjojnë pjesa tjetër.

Në arenën ndërkombëtare, universitetet shqiptare renditen në pozita të ulëta. Për shembull, Universiteti i Tiranës është renditur në pozicionin e 3906-të nga 4533 institucione në platformën SCImago për vitin 2023³². Kjo tregon për nevojën urgjente për përmirësime strukturore dhe cilësore në arsimin e lartë shqiptar.

Për më tepër, sipas Times Higher Education World University Rankings³³, vetëm Universiteti i Prishtinës është përfshirë në renditje, duke u pozicionuar në vendin e 1501-të. Mungesa e universiteteve shqiptare në këto renditje prestigjioze nënvizon sfidat e mëdha që sistemi arsimor shqiptar duhet të adresojë për të arritur standardet ndërkombëtare.

Sikurse mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm të gjithë opsionet e parashtruara paraqiten si shqetësime të studentëve të anketuar. Dukshëm më shqetësuese është mentaliteti i tyre për të arritur rezultate

● Kultura e mosdenoncimit të rasteve	83
● Mentaliteti i studentëve për të arritur lehtësisht notat e mira	146
● Rezultatet e ulëta të studentëve	90
● Presioni i pedagogëve	91
● Other	13



të kënaqshme ndjekur nga presioni i pedagogëve dhe rezultatet e ulta të studentëve.

Rënia e cilësisë së arsimit në universitetet shqiptare, e evidentuar nga statistikat e INSTAT dhe renditjet ndërkombëtare, lidhet ngushtë me qasjen e studentëve ndaj suksesit akademik. Përballë një sistemi që shpesh shihet si i dobët dhe i paefektshëm në ofrimin e arsimit cilësor, shumë studentë zgjedhin rrugë të shkurtra për të arritur rezultate të

³² https://feut.edu.al/lajmerime/2263-rankimi-i-universitetit-te-tiranes-2023?utm_source

³³ https://shqiptarja.com/lajm/universiteti-i-tiranws-nw-fund-tw-rankimit-ndwrkombwtar-renditet-i-667i-fakulitetet-mw-tw-mira-nw-rajon-klasifikohen-3-nw-serbi?utm_source

mira. Kjo qasje shpesh bazohet te nota si qëllim përfundimtar, duke injoruar vlerën e vërtetë të dijes. Në këtë kontekst, mungesa e meritokracisë dhe presioni për të pasur nota të larta për të garantuar punësim apo status social krijojnë një terren të përshtatshëm për akte korruptive. Studentët, në vend që të fokusohen te përvetësimi i njohurive, shpesh përdorin mjete të padrejta si ofrimi i parave në këmbim të notave. Ky fenomen nuk është thjesht pasojë e sistemit, por edhe një pasqyrim i një mentaliteti të përhapur që vlerëson më shumë rezultatin sesa procesin.


Në një sistem ku dijet nuk shpërblehen dhe kriteret e vlerësimit janë të dyshimta, studentët shpesh e shohin korrupsionin si një zgjidhje praktike, duke kontribuar kështu në përkeqësimin e mëtejshëm të nivelit akademik dhe duke minuar integritetin e arsimit të lartë në vend. Kjo spirale e rënies duhet të ndërpritet përmes reformave që promovojnë meritokracinë dhe vlerësojnë dije të mirëfillta mbi notat si qëllim i vetëm.

Lidhur me këto shkaqe që ndikojnë në ushqyerjen e klimës korruptive në universitetet publike në vend, shqetësimi më i madh është krijimi i kushteve të pabarabarta midis studentëve, me një numër të lartë përgjigjesh, që tregojnë shqetësime të theksuara për drejtësinë dhe barazinë në arsim. Pas tij, vjen ndikimi i dekurajimit të studimit, duke treguar se korrupsioni po ndikon në motivimin e studentëve. Po ashtu, deformimi i sistemit meritokratik dhe shtrembërimi i tregut të punës ndajnë të njëjtin nivel shqetësimi të barabartë, duke nxjerrë në pah ndikimet e gjera që shtrihen përtej arsimit në strukturat sociale dhe ekonomike. Ndërkohë, krijimi i një shoqërie të padrejtë e favorizuese është një tjetër shqetësim, duke reflektuar perceptimin e një shoqërie të ndikuar nga padrejtësia.

Më pak shqetësuese, por ende të rëndësishme, janë pasojat negative për zhvillimin demokratik të vendit, që tregojnë ndikimet e korrupsionit në nivel politik dhe institucional. Këto të dhëna janë një spektralitet i ndikimeve të korrupsionit që shtrihen nga arsimi deri te shoqëria dhe ekonomia.



Cili është shqetësimi më i madh që keni në raport me korrupsionin në sistemin arsimor?



8. RAPORTI PEDAGOG- STUDENT

Në përmbyllje të analizës me rëndësi është të gjykojmë edhe raportin pedagog- student në Universitetet Publike në vend. Ky raport është një tregues kyç për të kuptuar gjendjen aktuale të arsimit të lartë në Shqipëri, veçanërisht kur analizohet në kontekstin e statistikave që tregojnë rënien e numrit të studentëve dhe mbylljen e degëve në universitetet e rretheve. Në vitet e fundit, është vënë re një ulje e ndjeshme e regjistrimeve në universitete, veçanërisht jashtë Tiranës, për shkak të faktorëve të fillë si emigrimi i të rinjve, orientimi drejt universiteteve private ose institucioneve në qendrat më të mëdha si Tirana, dhe perceptimi i ulët i cilësisë në disa universitete të rretheve. Kjo rënie ka çuar në mbylljen e shumë degëve në universitete të vogla, pasi ato nuk kanë arritur të tërheqin një numër të mjaftueshëm studentësh për të justifikuar funksionimin e programeve.

Në këtë kontekst, raporti pedagog-student merr rëndësi sepse shfaq qartazi problemet strukturore që përballen universitetet e rretheve. Ky raport tregon se këto institucione po përballen me një "tepricë" të kapaciteteve pedagogjike përkundërt kërkesës. Në terma praktikë, kjo do të thotë që pedagogët mund të jenë të nënngarkuar me punë dhe të mos arrijnë të përmbushin plotësisht potencialin e tyre akademik, ndërsa kostot për mbajtjen e këtyre universiteteve mbeten të larta.

Rënia e numrit të studentëve lidhet edhe me pyetjen për qëndrueshmërinë e institucioneve në rrethe. Nëse këto universitete nuk arrijnë të ofrojnë programe atraktive që tërheqin studentët dhe të justifikojnë numrin e pedagogëve, mund të përballen me presion për të mbyllur degë ose për të reduktuar stafin akademik.

UNIVERSITETI	NR. STUDENTEVE	NR. PEDAGOGEVE	RAPORTI
UNI. I TIRANES	19401	790	1 pedagog per 24 studente
UNI. I MJEKESISE, TIRANE	6806	324	1 pedagog per 21 studente
UNI. BUJQESOR, TIRANE	6047	319	1 pedagog per 19 studente
UNI. POLITEKNIK I TIRANES	10515	742	1 pedagog per 14 studente
UNI. SPORTEVE	2113	114	1 pedagog per 18 studente
UNI. ARTEVE TIRANE	852	163	1 pedagog per 5 studente
UNI. SHKODER	3721	196	1 pedagog per 18 studente
UNI. ELBASAN	-	-	
UNI. KORCE	1894	149	1 pedagog per 12 studente
UNI. DURRES	9734	567	1 pedagog per 17 studente
UNI. VLORE	-	-	
UNI. GJIROKASTER	1992	111	1 pedagog per 17 studente

Tabela më sipër paraqet një pasqyrë të raportit pedagog-student në universitetet shqiptare, bazuar në informacionet e vëna në dispozicion nga vetë universitetet dhe sjell në vëmendje disa asimetri interesante që lidhen me shpërndarjen e burimeve njerëzore në arsimin e lartë. Universitetet më të mëdha, si Universiteti i Tiranës (UT) dhe Universiteti i Mjekesise Tiranë (UMT), kanë një raport relativisht të lartë, respektivisht 1 pedagog për 24 dhe 1 pedagog për 21 studentë. Nga ana tjetër, universitetet më të vogla, si ato në Korçë dhe Gjirokastër, kanë një raport shumë më të ulët, si 1 pedagog për 12 dhe 1 pedagog për 17 studentë. Ky dallim tregon një shpërndarje të pabarabartë të burimeve, ku universitetet e rretheve mbahen funksionale pavarësisht regjistrimeve të ulëta. Nëse ju referohemi vetëm dy universiteteve, **shohim se Uni. Korce edhe pse ka 5 herë më pak studentë ka një raport pothuaj të ngjashëm pedagog- student me Universitetin Politeknik të Tiranës.**

Ajo që bën më tepër përshtypje dhe që ndjek universitetet e rretheve është raporti në Universitetin e Arteve, i cili momentalisht ka 1 pedagog për 5 studentë.

Një nga arsyet kryesore për këtë disbalancë mund të jetë mbështetja institucionale për të garantuar akses në arsim në të gjitha qytetet e vendit, pavarësisht numrit të studentëve që ndjekin këto institucione. Kjo politikë mund të jetë e lidhur me qëllime sociale dhe zhvillimore, por nga një perspektivë ekonomike, mund të jetë e paqëndrueshme në rrafshin afatgjatë. Raporti pedagog-student në universitetet me numrin më të ulët të studentëve është gjithashtu tregues se numri i pedagogëve nuk është i lidhur drejtpërdrejt me numrin e studentëve, por me qëllimin për të mbajtur këto institucione të hapura. Krahasimi me universitetet më të mëdha, që përballen me një mbingarkesë, e bën këtë kontrast më të dukshëm.

Kjo situatë ngre pyetje mbi efektivitetin dhe drejtësinë e shpërndarjes së burimeve në sistemin e arsimit të lartë. Universitetet më të mëdha mund të përballen me sfida të cilësisë për shkak të numrit të lartë të studentëve për pedagog, ndërsa universitetet e rretheve mund të kenë kapacitete të pashfrytëzuara. Në terma strategjikë, një rishikim i strukturës së arsimit të lartë në Shqipëri mund të jetë i nevojshëm për të optimizuar burimet, duke ruajtur një balancë midis aksesit dhe efikasitetit.

9. GJETJET KRYESORE:

1. 77% e studentëve, të anketuar, thonë se korrupsioni ekziston në universitetet e tyre. Nga ana tjetër nëse i referohemi më ngushtë perceptimit të studentëve lidhur me fenomenin e shfaqjes së korrupsionit në nivel program studimi apo departamenti, 62.2 % e të anketuarve pranojnë ekzistencën e fenomenit në këtë nivel. Ky trend në rënie mund të jetë edhe për shkak të frikës që mund të kenë pasur studentët për të qenë plotësisht të sigurtë në lidhje me programin e tyre të studimit, duke qenë se janë më afër kësaj hierarkie sesa rangut universitar
2. Parë në raport krahasimor mes katër universiteteve me numrin më të lartë të të anketuarve, prania e korrupsionit shfaqet më e lartë në Universitetin e Mjekësisë me 100% dhe më e ulët në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Universitetin e Shkodrës.
3. 79% e studentëve bazohen në përvojat personale e përvojat e bashkëmoshatarëve ose familjarëve mbi praninë e korrupsionit. Ndërkohë, krahas ndikimit të medias në jetën tonë, vetëm 15% shprehen se janë vënë në dijeni të praktikave korruptive përmes raportimeve në media.
4. 51% e të anketuarve besojnë se të dy grupet, si administrata ashtu edhe trupa akademike, janë të përfshira në mënyrë të barabartë. Kjo sinjalizon se këta aktorë të sistemit janë të lidhur me njëri-tjetrin në përfshirjet korruptive, ky është një fakt për këtë

- lidhje sepse roli ndërmjetës mes studentëve dhe pedagogëve në shumicën e rasteve luhet nga punonjësit e administratës
5. **"Pagesa në këmbim të notës"** zë vendin kryesor dhe na tregojn qartazi se kjo formë është e perceptuar si më e përhapura. Kjo vë në dukje një shqetësim të madh mbi integritetin akademik, ku duket se vlerësimi i dijes është shndërruar në një transaksion financiar.
 6. Lidhjet familjare apo sociale mes personelit akademik dhe administratës të universiteteve vazhdojnë të kenë një ndikim të ndjeshëm në sistemin arsimor. Për shumë studentë, perceptimi që "lidhjet e dhura" mund të sigurojnë përparësi është shqetësues dhe nënvizon mungesën e meritokracisë.
 7. Në universitet, shpesh sekretarët, administratorët apo individë të tjerë brenda sistemit shërbejnë si ura ndërmjetëse midis studentëve dhe pedagogëve. Kjo formë tregon se korrupsioni është i organizuar dhe shpesh përfshin një rrjet të gjerë aktorësh.
 8. Mosinteresimi i studentëve për të reaguar është një tregues i qartë i dy faktorëve kryesore, frikës nga autoriteti i akademikut dhe mosbesimi në strukturat përkatëse për gjykimin e drejtë të fenomenit. Ndërkaq 49% e tyre shprehen se rastet e korrupsionit nuk janë denoncuar.
 9. Edhe pse një pjesë e vogël(4%) mendojnë se rastet korruptive denoncohen, vetëm 2% e të anketuarve shprehen se janë marrë masa për adresimin e tyre, 39% nuk kanë informacion mbi masat e marra dhe 59% e tyre nuk kanë përgjigje. Pra studentët jo vetëm që nuk revoltohen e nuk denoncojnë, por nëse i grupojmë dy kategoritë "nuk janë marrë masa" dhe "nuk e di/ pa përgjigje", shohim se 98% e tyre nuk kanë as interes të mësojnë çfarë ndodh me rastet e raportuara nga të tjerë.
 10. Gjatë periudhës 2021-2024, **SPAK** ka trajtuar raste të korrupsionit që përfshijnë personel akademik në Universitete Publike. Në total, janë kallëzuar 2 pedagogë dhe janë hetuar 7, me përqendrim më të lartë të rasteve në vitin 2024 (5 raste).
 11. Nga verifikimi i kryer në zyrat e regjistrimit të prokurorive lidhur me kallezimet/procedimet penal dhe me numrin e individëve, pjesë e personelit akademik të Universiteteve Publike në Shqipëri, gjatë viteve 2021 - 2024, janë raportuar për korrupsion pasiv dhe aktiv 18 pedagogë.
 12. Nga 2021 deri në 2024, numri i të paditurve është rritur ndjeshëm, duke kaluar nga një mesatare prej 2-3 rasteve vjetore në fillim, në 8 raste në vitin e fundit. Kjo rritje mund të lidhet me kontrollë më të ashpra nga autoritetet ose me një rritje të aktiviteteve të dyshuara të korrupsionit nga personelit akademike.
 13. Vetëm 11% e studentëve të intervistuar tregojnë një nivel besimi në aftësinë e sistemit për të ndëshkuar rastet korruptive. Këta studentë janë të bindur se sistemi i drejtësisë funksionon si duhet

në rastet të tilla, pa marrë parasysh realitetin e hidhur në të cilin ndodhemi. Nga ana tjetër 56% e të pyeturve, që përbëjnë edhe numrin më të madh, janë plotësisht të pashpresë, ndërsa 33% janë të pavendosur në pikëpamjet e tyre.

14. "Kulti i notes" tek studentët mbetet një fenomen që sa vjen dhe ushqehet akoma më shume. Bazuar anketimit, 38% e studentëve do të ofronin para kundrejt një note më të mire, kjo i ben ata pale ne korrupsion.
15. Frika e hakmarrjes nëpërmjet penalizimit me note, Mosbesimi në marrjen e masave, Klanet e forta brenda universitetit, Mosinteresi i studentëve lidhur me raste që nuk i prekin ata direkt, janë arsyt kryesore qe i çojnë studentet drejt mosreagimit.
16. Universiteti i Korces edhe pse ka 5 herë më pak studentë ka një raport pothuaj të ngjashëm pedagog- student me Universitetin Politeknik të Tiranës. Ndërkohë bie në sy Universiteti i Arteve i cili ka 1 pedagog për 5 studentë.

10. REKOMADIMET:

1. Të ndryshohen dhe përmirësohen ligjet ekzistuese duke përfshirë masa specifike kundër korrupsionit, të tilla si dënime më të ashpra për personelin akademik dhe administrativ të përfshirë në akte korruptive. Krijimi i një institucioni të pavarur për monitorimin dhe raportimin e rasteve të korrupsionit në universitete do të jetë një hap i domosdoshëm.
2. Universitetet duhet të publikojnë periodikisht raportime të detajuara mbi notat, procedurat e pranimit, dhe kriteret për vlerësim. Duke përdorur sisteme digjitale për këto procese, ndërhyrja e faktorit njerëzor dhe rrjedhimisht korrupsioni do të minimizohet.
3. Organizimi i trajnimeve dhe diskutimeve rreth ndikimit negativ të korrupsionit në cilësinë e arsimit dhe të ardhmen e studentëve. Studentëve duhet t'u ofrohen kanale të sigurta dhe anonime për të raportuar praktikave korruptive pa frikë nga hakmarrja.
4. Sistemi i vlerësimit të studentëve duhet të mbështetet në teste të standardizuara dhe të administruara nga palë të pavarura. Një vlerësim i tillë do të ndihmojë në reduktimin e ndikimit të ndërhyrjeve subjektive dhe praktikave korruptive.
5. Të implementohen procedura të repta për punësimin e stafit akademik dhe administrativ duke eliminuar nepotizmin dhe

ndikimet familjare apo miqësore. Vlerësimi i kandidatëve duhet të kryhet bazuar vetëm në kritere profesionale dhe përvojë.

6. Duhet që nëpërmjet instrumentave ligjore dhe administrative të krijohen zyra ose instrumenta të posaçme për adresimin e korrupsionit në nivel universiteti, fakulteti e departamenti.
7. Krijimi i një departamenti të dedikuar brenda Ministrisë së Arsimit që bashkëpunon me Prokurorinë dhe Policinë për të hetuar rastet e korrupsionit në universitete. Ky departament duhet të ketë mandat të qartë për të ndjekur në mënyrë proaktive raportimet dhe për të kryer inspektime të papritura në universitetet publike dhe private.
8. Krijimi i një platforme kombëtare për raportimin e korrupsionit dhe i mbështetur nga organet hetimore, i cili ofron mundësinë e raportimit anonim për praktikat korruptive. Kjo platformë duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme dhe të garantojë konfidencialitetin e raportuesve.
9. Ministria e Arsimit dhe organet hetimore duhet të ndjekin penalizime të ashpra për personat që shkelin ligjin, duke përfshirë largimin e përhershëm nga detyra, gjoba të larta dhe ndalime për të punuar në sektorin publik.

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al